REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DECANI - OPSTINA DECANI

DEÇANI

Zyra e Kryetarit
Komisioni Komunal për Regjistrim

02 Nr. Zyrtarisht
Dt. . 21 / 02 / 2011

# SHPALL

## KONKURS PËR PRANIMIN E REGJISTRUESVE NË PROJEKTIN E REGJIOSTRIMIT TË POPULLSISË NË KOSOVË

Të gjithë kandidatët e interesuar të cilët i plotësojnë kriteret e mëposhtme mund të aplikojnë për punën e regjistruesit në projektin e regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Kosovë.

1. Të jetë banor i Kosovës , dhe të paraqesë dëshminë e identitetit.
2. Të ketë reputacion të mirë dhe të mos jetë nën hetime.
3. Të ketë kualifikim universitar, shkollën e lartë,përvojën në shërbimet statistikore, për zona të caktuara , të ketë të kryer shkollimin e mesëm.
4. Të jetë banor i komunës së Deçanit.
5. Të jetë i gatshëm të marrë pjesë në sesionet e trajnimeve.
6. Të jetë i lirë nga secila punë obligative.
7. Të ketë telefon mobil dhe leje për vozitje
8. Të jetë i gatshëm të punojë me orar të zgjatur.

DETYRAT DHE PERGJEGJËSITË
Regjistruesit do të trajnohen nga Kontrollorët. Regjistruesi është person i cili bënë mbledhjen e të dhënave për ekonomitë familjare me anë të pyetësorëve. Intervista zhvillohet drejtpërsëdrejti me anëtarët e ekonomive familjare duke i vizituar derë më derë.

KOHËZGJATJA E PUNËS – Punësimi do të zgjasë 1 muaj nga 20 marsi deri me 20 prill.
ORARI I PUNËS – Puna ditore e regjistrimit zakonisht kryhet brenda orarit prej orës 08:00 deri në orën 20:00.
KONKURSI DO TË JETË I HAPUR PËR APLIKIM NGA DATA 21.02.2011 deri më 04.03.2011

Kryetari i Komisionit Komunal
Rasim Selmanaj

Nga: Zyra Kryetarit
Nr. Prot: 795
Nr i tegeve: 02
Data: 21.02.2011
DEÇAN DECANE